



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURSË PUBLIKE

Nr. 2571/1 prot.

Tiranë, më 13.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 13012/1 prot., datë 06.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2571 prot., datë 10.12.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”, si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit dhe relacionit shoqërues në tërësi, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky projektvendim është konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi